

Akreditimi i mediave në Kuvendin e Shqipërisë

Kuvendi i Shqipërisë gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij udhëhiqet nga parimi i garantimit të së drejtës së informimit dhe transparencës në raport me publikun. Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediat audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë.

Akreditimi kryhet në bazë të kërkesës së institucionit mediatik pranë të cilit janë të punësuar personat që do të akreditohen. Punonjës të mediave të akredituar për të ndjekur punimet e Kuvendit të Shqipërisë janë 800 persona, ku përfshihen gazetarë, operatorë dhe fotografë nga televizionet, media e shkruar, media elektronike dhe agjenci të ndryshme.

Më konkretisht, pranë Kuvendit të Shqipërisë janë të akredituar;

Gazetarë nga 13 media të shkruara (gazeta)

Gazetarë+operatorë nga 24 televizione

Gazetarë+fotografë nga 10 agjenci

Gazetarë+operatorë nga 7 media elektronike (portale)